

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V. – Dega ne Shqiperi

**Pasqyrat Financiare
me dhe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020**

PERMBAJTJA:

	Faqe
PASQYRAT FINANCIARE	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TE TE ARDHURAVE TE TJERA GJITHEPERFSHIRESE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO	5
PASQYRA E FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE	6
SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE	7-39

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V. – Dega ne Shqiperi
Pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2020
(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije leke)

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR


AKTIVET	Shenime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019	1 janar 2019
Aktivitet afatgjata				
Aktive kerkimi dhe vleresimi	5	24,184,559	25,814,168	40,295,397
Aktive afatgjata materiale	6	60,087	64,293	-
E drejta e perdorimit te aktiveve	7	33,333	73,430	112,045
Totali i aktiveve afatgjata		24,277,980	25,951,891	40,407,442
Aktivitet afatshkurtra				
Te drejta dhe te tjera te arketueshme	8	1,080	10,614	3
Aktive te tjera afatshkurtra	9	261,830	235,216	184,451
Inventar	10	766,845	913,478	957,100
Llogari financimi e brendshme	11	2,041,258	1,387,985	1,701,751
Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre	12	43,800	41,913	43,606
Totali i aktiveve afatshkurtra		3,114,814	2,589,206	2,886,911
TOTALI I AKTIVEVE		27,392,794	28,541,097	43,294,353
KAPITALI				
Humbje te akumuluar		(48,591,034)	(44,049,211)	(17,106,807)
Rezerva perkthimi		2,323,185	(1,250,638)	(1,406,589)
		(46,267,849)	(45,299,849)	(18,513,396)
DETYRIMET				
Detyrimet afatgjata				
Fonde nga shoqeria meme	13	60,352,740	59,589,040	52,723,980
Detyrime per qirane	16	-	38,687	75,741
		60,352,740	59,627,727	52,799,721
Detyrimet afatshkurtra				
Detyrime dhe te tjera llogari te pagueshme	14	629,304	3,253,160	985,998
Tatime te pagueshme	15	133,128	43,488	21,448
Detyrime per qirane	16	36,027	37,633	36,304
Detyrime te perlllogaritura ndaj paleve te lidhura	17	12,509,444	10,878,938	7,964,278
		13,307,903	14,213,219	9,008,028
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		27,392,794	28,541,097	43,294,353

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 deri 38 qe jane pjese perberese e Pasqyrave Financiare. Keto Pasqyra Financiare jane pergatitur me asistencen e Deloitte Albania sh.p.k (NIPT J62329003N) dhe jane miratuar nga perfaqesuesi ligjor i Shell Upstream Albania BV - Dega ne Shqiperi, me 10.11.2021.

Pergatiti:
Deloitte Albania shpk

Miratuar nga:

Anthony Marinus Frens, Manager i pergjatesimit
Shell Upstream Albania B.V. – Dega ne Shqiperi



SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V. – Dega ne Shqiperi**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera gjithëperfshirese per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020***(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke)***PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TE ARDHURAVE TE TJERA GJITHEPERFSHIRESE**

	Shenime	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 (riparaqitur) (te pa audituar)
Te ardhurat	19	20,250	8,946
Shpenzime te aktivitetit operativ			
Shpenzime personeli	20	(1,694,161)	(504,528)
Shpenzime operative	21	(2,234,501)	(2,807,464)
Nxjerrje jashte e inventarit	22	(459,739)	-
Shpenzime amortizimi	6,7	(81,129)	(39,909)
Zhvleresim i puseve		(131,005)	(23,653,254)
Shpenzime te tjera	23	(40,526)	(11,029)
Totali i shpenzimeve operative		(4,641,061)	(27,016,184)
Humbje operative		(4,620,811)	(27,007,238)
Shpenzime financiare	24	(62,137)	(32,219)
Te ardhura financiare	24	141,125	97,053
(Humbja)/fitimi financiar neto		78,988	64,834
Humbja para tatimit		(4,541,823)	(26,942,404)
Shpenzimi per tatimin mbi fitimin		-	-
Humbja e vitit		(4,541,823)	(26,942,404)
Te ardhura te tjera gjithëperfshirese neto pas tatimit mbi fitimin:			
Diferenca perkthimi		3,573,823	155,951
Humbja gjithëperfshirese e vitit		(968,000)	(26,786,453)

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe te Ardhurave gjithëperfshirese duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 deri 39 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V.– Dega ne Shqiperi
Pasqyra e ndryshimeve ne kapital per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020
(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke)

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL

	Rezerva nga perkthimet	Humbje te mbartura	Kapitali total
Gjendja me 1 janar 2019 (riparaqitur) (te pa audituara)	(1,406,589)	(17,106,807)	(18,513,396)
<i>Totali i humbjes gjithperfshirese per vitin:</i>			
Humbja e vitit	-	(26,942,404)	(26,942,404)
Te ardhura te tjera gjithperfshirese	155,951	-	155,951
Totali i humbjes gjithperfshirese per vitin	155,951	(26,942,404)	(26,786,453)
Gjendja me 31 dhjetor 2019 (riparaqitur) (te pa audituara)	(1,250,638)	(44,049,211)	(45,299,849)
Gjendja me 1 janar 2020	(1,250,638)	(44,049,211)	(45,299,849)
<i>Totali i humbjes gjithperfshirese per vitin:</i>			
Humbja e vitit	-	(4,541,823)	(4,541,823)
Te ardhura te tjera gjithperfshirese	3,573,823	-	3,573,823
Totali i humbjes gjithperfshirese per vitin	3,573,823	(4,541,823)	(968,000)
Gjendja me 31 dhjetor 2020	2,323,185	(48,591,034)	(46,267,849)

Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapitalin Neto duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 deri 39, qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V.– Dega ne Shqiperi
Pasqyra e flukseve te mjeteve monetare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020
(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke)

PASQYRA E FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE

	Shenime	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 (riparaqitur) (te pa audituar)
Flukset monetare te gjeneruara nga (perdorur ne) aktivitetet operative			
Humbja e vitit		(4,541,823)	(26,942,404)
<i>Rregullime per:</i>			
Zhleresimin e puseve		108,044	23,653,254
Shpenzime interesi	25	(4,916)	(84,144)
Nxjerrje jashte te inventarit		459,739	-
Amortizimi i aktiveve materiale	6	43,109	-
Amortizimi i te drejtave te perdorimit te aktiveve	7	38,020	39,907
Zbritje e parealizuar ne detyrimet per qirane	16	4,767	7,799
		(3,893,060)	(3,325,589)
Ndryshimet ne kapitalin punues:			
Ndryshimi ne inventar	10	(372,517)	51,468
Ndryshimi ne te drejta dhe te tjera te arketueshme	8	9,440	(10,730)
Ndryshimi ne aktive te tjera afatshkurtra	9	(46,814)	(49,912)
Ndryshimi ne detyrime dhe te tjera llogari te pagueshme	14	(2,572,334)	2,284,830
Ndryshimi ne detyrimet tatimore	15	99,822	22,125
Ndryshimi ne detyrimet e perlllogaritura ndaj paleve te lidhura	17	2,595,244	2,885,877
Mjete monetare neto gjeneruar nga (perdorur ne) aktivitetet operative		(4,180,219)	1,858,070
Fluket monetare te gjeneruara nga (perdorur ne) aktivitetet e investimit			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	6	(43,552)	(65,008)
Kostot e kerkimit dhe vleresimit	5	(348,856)	(8,700,855)
Interes i marre	25	4,916	84,144
Mjete monetare neto perdorur ne aktivitetet e investimit		(387,492)	(8,681,719)
Fluket monetare te gjeneruara nga (perdorur ne) aktivitetet e financimit			
Ndryshimi ne llogarine e financimeve te brendshme	11	(810,270)	330,348
Ripagesa e detyrimeve te qirase	16	(42,553)	(44,783)
Fonde te marra nga shoqeria meme	13	5,426,000	6,536,075
Mjete monetare neto nga veprimtaria financuese		4,573,177	6,821,639
(Pakesimi)/rritja neto ne mjete monetare dhe ekuivalente te tyre		5,466	(2,014)
Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre ne 1 janar		41,913	43,606
<i>Efekti i ndryshimit te kursit te kembimit ne mjete monetare dhe ekuivalente te tyre</i>		(3,579)	321
Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre ne 31 dhjetor		43,800	41,913

Pasqyra e Fluksit te Mjeteve Monetare duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 7 deri ne 39
qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V.– Dega ne Shqiperi

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare ne dhe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke, pervec se kur percaktohet ndryshe)

1. INFORMACIONE TE PERGJITHSHME

Shell Upstream Albania B.V. – Dega ne Shqiperi (referuar ketej e tutje si “SUA” ose “Dega”) eshte dege e Shell Upstream Albania B.V., themeluar ne Hollande (referuar si “Shell” ose “shoqeria meme”), filial i shoqerise shumekombeshe te naftes dhe gazit Royal Dutch Shell plc, shoqeria meme perfundimtare e Shell Upstream Albania B.V.. Dega eshte regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, me 7 qershor 2012, ne perputhje me Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, me numer unik identifikimi tatimor (NUIIS/NIPT) L21807009I, me adrese ne Bulevardi "Bajram Curri", European Trade Center, kati 5, Njesia Bashkiake Nr. 2, Tirane, Administratori i se ciles eshte Z. Anthonie Marinus Frens.

Aktiviteti kryesor i Deges eshte te ndermarre te gjithë operacionet per Kerkim, Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve ne Shqiperi, specifikisht ne Bllokun 2-3 ne toke. Me 9 shkurt 2012, Shell Upstream Albania B.V. mori 50% te interesit pjesemarres nepermjet nje marreveshje transferimi dhe marreveshje operimi te perbashket te Kontrates me Ndarje Prodhimi (“KNP”) per Blloqet 2-3 ne Shqiperi, ne toke, ne ate kohe nen operim nga Petromanas Albania GmbH (PMI) nepermjet nje dege te regjistruar ne Shqiperi. Me 20 qershor 2013, Shell dhe Petromanas Albania GmbH nenshkruan nje shtese te marreveshjes se transferimit per KNP-ne per Blloqet 2-3 ne Shqiperi, marreveshje e lidhur fillimisht mes paleve ne shkurt 2012. Kjo shtese i siguroi Shell nje interes shtese prej 25%. Shell mori ne zoterim 100% te interesave ne 1 mars 2016 pas blerjes se 25% te interesave te mbetur nga Petromanas Albania GmbH dhe, si rrjedhoje e ketij procesi, mori rolin e Operatorit per Blloqet 2-3. Operacionet e shpimit ne pusin Shpirag-3 filluan ne 5 qershor 2016 ne perputhje me kerkesat e KNP-se. Operacionet e shpimit ne pusin Shpirag-3 u nderprene ne dhjetor 2017, rifilluan ne korrik 2019 dhe u pezulluan perfundimisht ne nentor 2019 (shenimi 9). Ne janar 2018, Dega filloi operacionet ne pusin Shpirag-4. Ne shkurt 2018, Shell ka nenshkruar me qeverine shqiptare KNP-ne per Bllokun 4, ne jug te Blloqeve 2-3, te miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave nr. 350, date 12 qershor 2018. Ne 18 korrik 2019, SUA transferoi 100% te interesit ne KNP-ne per Bllokun 4 te nje filial tjetër i Royal Dutch Shell plc, Shell Albania Block 4 B.V.- Dega ne Shqiperi (SAB 4) (shenimi 9). Akti i Transferimit u be efektiv ne 6 shtator 2019, kur SUA transferoi te SAB 4 edhe pjesen e saj te aktivitetit ekonomik qe lidhet me operacionet e KNP-se per Bllokun 4. SUA ka vazhduar te operoje si zakonisht KNP-ne per Blloqet 2-3, para dhe pas transferimit te aktivitetit ekonomik te SAB 4. KNP-ja parashikon 3 (tre) periodha kerkimi. Ne rast te nje zbulimi tregtar te naftes, faza e zhvillimit dhe e kerkimit do te fillojne ne perputhje me termat dhe kushtet e rena dakord ne KNP.

Gjate vitit 2020, si pasoje e nevojës per organizimin e planit per operacionet te metejshme ne puse dhe si pasoje e pandemise Covid-19 ne te njejten kohe, te gjithë operacionet ne fushe u pezulluan. Te vetmet operacione qe vazhduan ishin ato te lidhura me mirembajtjen, po nuk ka ndodhur asnje shpim. Per detaje te metejshme mbi efektet e pandemise Covid-19 lexoni shenimin 2.2. Gjate vitit 2020, Dega ka patur mesatarisht 56 punonjes (2019: 65). Ne vijim te parashkimieve te Ligjit nr. 25/2018, SUA konsiderohet si nje Shoqeri me Interes Publik prej cilesise se saj si dege e Shell Upstream Albania B.V. e themeluar ne Hollande nje filial i shoqerise shumekombeshe te naftes dhe gazit Royal Dutch Shell plc, shoqeria meme perfundimtare e Shell Upstream Albania B.V., e cila eshte nje shoqeri e listuar ne burse.

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V.– Dega ne Shqiperi

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare ne dhe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke, pervec se kur percaktohet ndryshe)

2. BAZAT E PERGATITJES

2.1 Deklarata e perputhshmerise

Ky eshte seti i pare i pasqyrave financiare qe jane pergatitur ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (“SNRF”) te leshuara nga Bordi i Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit (BSNK).

Nepermjet nje Vendimi te Keshillit te Ministrave nr. 180, date 26 shkurt 2020 dhe publikuar ne Fletoren Zyrtare nr. 25, date 28 shkurt 2020, KNP-ja per Bllokun 2-3 eshte ndryshuar dhe riformuluar dhe si rrjedhoje e parashikimeve te reja te perfshira ne Aneksin C “Procedura Kontabel” e KNP-se, SUA do te mbaje llogarite e saj kontabel ne perputhje me SNRF.

Ne perputhje edhe me SNRF 1 “Zbatimi i Standardeve Nderkombetare te Raportimit Financiar per here te pare”, Dega ka zbatuar SNRF ne menyre retrospektive duke riparaqitur zerat e pasqyrave financiare te periudhave te meparshme. Ne keto pasqyra financiare, Dega ka paraqitur shpjegime mbi zbatimin e standardeve qe ndikojne ne pasqyren e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2020 ne shenimin 4.

Keto pasqyra financiare jane pergatitur me asistencen e shoqerise Deloitte Albania sh.p.k me NIPT J62329003N, adresa Rruga ‘Faik Konica’, Ndertesha nr. 6, Hyrja nr. 7, 1010, Tirane, regjistruar ne Institutin e Kontabilisteve te Miratuar me perfaqesuese ligjore znj.Albana Shahu, kontabiliste e miratuar me licence nr. 241, date 27.08.2012.

2.2 Parimi i vijimesise

Deri me 31 dhjetor 2020, Dega kishte akumuluar humbje prej 48,591,034 Leke (2019: 44,049,211 Leke) te cilat i atribuohen kryesisht fazes se kerkimit per Blloqet 2-3. Gjate kesaj faze, Dega eshte mbeshtetur me financime afatgjata nga shoqeria meme per te vazhduar operacionet e kerkimit dhe vleresimit dhe per te permbushur nevojat per likuiditete. Shoqeria meme eshte e angazhuar te vazhdoje ofrimin e nje mbeshtetjeje te tille financiare ne te ardhmen, ne varesi te nevojave operacionale.

Sipas rrethanave dhe bazuar ne sa eshte shprehur me lart, drejtuesit besojne se Dega do te jete ne gjendje te vazhdoje aktivitetin sipas parimit te vijimesise dhe nuk ka asnje qellim per likuidimin e operacioneve ne nje te ardhme te afert. Per rrjedhoje, Dega i ka pergatitur keto pasqyra financiare ne baze te parimit te vijimesise.

2.3 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Keto pasqyra financiare jane prezantuar ne Lek (ALL), ndersa monedha funksionale e Deges eshte Dollari Amerikan (“USD”). Politika e pergatitjes se pasqyrave financiare ne monedhen funksionale eshte e prezantuar ne Shenimin 2.4. Te gjitha vlerat jane rrumbullakosur ne te mijten me te afert, pervec se kur eshte percaktuar ndryshe.

2. BAZAT E PERGATITJES (VAZHDIM)

2.5 Perdorimi i vleresimeve, gjykimeve dhe supozimeve

Pergatitja e pasqyrave financiare ne perputhje me SNRF-te kerkon nga drejtuesit e Deges te ushtrojne gjykimin e tyre ne procesin e zbatimit te politikave kontabel te Deges dhe ne raportimin e te gjitha vlerave te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati faktik mund te ndryshoje nga keto vleresime. Vleresimet dhe gjykimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e vleresimeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen vleresimi eshte rishikuar, si dhe ne periudhat e ardhme qe preken. Informacioni mbi fushat me te rendesishme te vleresimeve, pasigurise dhe gjykimeve kritike ne zbatimin e politikave kontabel ne keto pasqyra financiare eshte perfshire ne shenimet vijuese.

Supozimet kryesore ne lidhje me te ardhmen dhe burimet e tjera kryesore te vleresimit te pasigurise ne daten e raportimit qe kane nje risk te konsiderueshem per te shkaktuar nje rregullim material te vleres kontabel te mbetur te aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit te ardhshem financiar, jane pershkruar me poshte. Dega i bazoi supozimet dhe vleresimet e saj ne parametrat e disponueshem kur u pergatiten pasqyrat financiare te konsoliduara.

Megjithate, rrethanat ekzistuese dhe supozimet per zhvillimet e ardhshme mund te ndryshojne per shkak te ndryshimit te tregut ose rrethanave qe dalin jashte kontrollit te deges. Ndryshime te tilla reflektohen ne supozime kur ato ndodhin.

Informacioni ne lidhje me gjykimet e bera ne zbatimin e politikave kontabel qe kane efektet me te rendesishme ne shumat e njohura ne pasqyrat financiare jane paraqitur me poshte:

(i) Zhvleresimi i aktiveve te kerkimit dhe vleresimit

Ne fund te periudhes raportuese, manaxhimi gjykoi se kishte fakte dhe rrethana qe do te sugjerinin per nje zhvleresim te aktivitetit te kerkimit dhe vleresimit dhe ka vendosur te zhvleresoje me tej disa kosto te bera gjate vitit 2020 ne lidhje me pushtet e zhvleresuara gjate vitit 2019. Ju lutemi referojuni shenimit 5 per detaje te metejshme mbi treguesit e zhvleresimit.

(ii) Shpenzimet e kerkimit dhe vleresimit

Zbatimi i politikave kontabel te Deges per shpenzimet e kerkimit dhe vleresimit kerkon gjykim per te percaktuar nese perfitimet ekonomike te ardhshme jane te mundshme nga shfrytezimi ose shitja ne te ardhmen, ose nese aktivitetet nuk kane arritur ne nje faze qe lejon nje vleresim te arsyeshem te ekzistences se rezervave. Percaktimi i rezervave dhe burimeve eshte, ne vetvete, nje proces vleresimi qe perfshin shkalle te ndryshme pasigurie ne varesi te menyres se si klasifikohen burimet.

Keto vleresime ndikojne drejtperdrejt kur Dega shtyn shpenzimet e kerkimit dhe vleresimit. Politika e shtyrjes kerkon qe manaxhimi te beje vleresime dhe supozime te caktuara ne lidhje me ngjarjet dhe rrethanat e ardhshme, ne vecanti, nese mund te krijohet nje operacion nxjerrjeje ekonomikisht i qendrueshem. Çdo vleresim dhe supozim i tille mund te ndryshoje kur informacioni i ri behet i disponueshem. Nese, pasi shpenzimi eshte kapitalizuar, informacioni behet i disponueshem dhe sugjeron se rikuperimi i shpenzimeve nuk ka gjasa, shuma perkatese e kapitalizuar fshihet ne pasqyren e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera gjithepershires ne periudhen kur informacioni i ri behet i disponueshem.

2. BAZAT E PERGATITJES (VAZHDIM)

2.5 Perdorimi i vleresimeve, gjykimeve dhe supozimeve (vazhdim)

(iii) Monedha funksionale

Ne percaktimin e monedhes funksionale, kerkohet gjykimi perkates per te marre parasysh se cila eshte monedha e mjedisit primar ekonomik ne te cilin operon Dega. Ne kete gjykim, perparesi kane treguesit paresore dhe treguesit dytesore te monedhes funksionale te Deges dhe gjykimi perkates perdoret ne percaktimin e monedhes funksionale, e cila paraqet ne menyre te drejte dhe te vertete transaksionet, ngjarjet dhe kushtet kryesore te Deges.

Si rrjedhoje e zbatimit per here te pare te IFRS, manaxhimi ka ri-vleresuar treguesit paresore dhe dytesore te monedhes funksionale te Deges dhe ka vleresuar se monedha funksionale qe tregon ne

menyre te drejte dhe te vertete transaksionet kryesore, ngjarjet dhe rrethanat e Deges eshte USD, per rrjedhoje ka vendosur ndryshimin e monedhes funksionale nga Leke ne USD, duke filluar nga data e themelimit te Deges.

(iv) Transaksionet me palet e lidhura

Dega ka patur transaksione me pale te lidhura gjate viteve 2020 dhe 2019 per blerje mallrash dhe sherbimesh, per kryerjen e sherbimeve, si dhe transferta ne baze te nje marreveshjeje financiare me shoqerine meme. Keto transaksione me palet e lidhura u kryen me kushte te barabarta me ato qe mbizoterojne ne transaksionet sipas parimit te tregut.

Ne fazen e kerkimit, manaxhimi i Deges gjykon se financimi nga njesia ekonomike meme perbehet nga nje kapital i transferuar ne Dege dhe njeh fondet nga shoqeria meme, dhe jo si instrument kapitali per shkak te sa vijon:

- a) Forma juridike e Deges ne Shqiperi. Financimi u be nga aksionaret e shoqerise meme perkundrejt shoqerise meme. Prandaj, financimet ne pasqyren financiare te subjektit kryesor te regjistruar ne Hollande jane paraqitur si hua te pagueshme, perkundrejt paraqitjes se tyre ne pasqyrat financiare te Deges.
- b) Faza e kerkimit ne te cilin eshte Dega ne kete moment. Faza e kerkimit ne te cilen ndodhet aktualisht Dega, eshte nje faze qe shpesh eshte shume dinamike per sa i perket planit te operimit. Plani perditesohet vazhdimisht duke u bazuar ne aktivitetet aktuale te operimit ne terren dhe ne baze te informacionit te mbledhur nga keto aktivitete jane te mundshme te gjitha skenaret, duke perfshire edhe braktisjen ne rast se do te ndodhte qe nuk do te ishte ekonomikisht e vlefshme hyrja ne fazen tjeter te operacioneve.
- c) Qellimin qe shoqeria meme ka per shumen e transferuar. Duke patur parasysh pasigurine e fazes se kerkimit te aktiviteve, fondet nga aksionaret e shoqerise meme do te trajtohen ndryshe ne nje moment ne te ardhmen – huaja ose do te transferohet ne prim aksionesh me hyrjen ne fazen e zhvillimit, ose do te leshohet nje ndryshim kontrate se bashku me planin e pagesave.

2.6 Zbatimi fillestar i standarteve nderkombetare te raportimit financiar (SNRF) te reja dhe te rishikuara, efektive per periudhen raportuese

Standardet e reja te meposhtme, ndryshimet ne standardet ekzistuese dhe interpretimi i leshuar nga Bordi i Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit (BSNK) jane ne fuqi per periudhen aktuale te raportimit:

- **Ndryshime ne SNRF 3 “Kombinimet e Biznesit”** - Perkufizimi i nje Biznesi (efektive per kombinimet e bizneseve, per te cilat data e blerjes eshte ne ose pas fillimit te periudhes se pare te raportimin periodik qe fillon ne ose pas 1 janarit 2020 dhe per blerjen e aktiveve qe ndodhin ne dhe pas fillimit te asaj periudhe);
- **Ndryshime ne SNRF 9 “Instrumentet Financiare”, SNK 39 “Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja” dhe SNRF 7 “Instrumentet Financiare: Dhenie Informacionesh Shpjeguese”** – Reforma Normes Krahasuese te Interesit (efektive per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janar 2020);
- **Ndryshimet ne SNRF 16 "Qirate"**- Koncesionet e Qirase ne lidhje me Covid-19 (efektive per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 qershorit 2020. Lejohet zbatimi i meparshem, perfshire pasqyrat financiare qe nuk jane autorizuar ende per tu leshuar ne 28 maj 2020. Ndryshimi eshte gjithashtu i disponueshem per raportet e ndermjetme);
- **Ndryshimet ne SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare" dhe SNK 8 "Politikat Kontabel, Ndryshimet ne Vleresimet Kontabel dhe Gabimet"**. Perkufizimi i Materialitetit (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2020);
- **Ndryshimet ne Referencat ne Kuadrin Konceptual ne Standartet e SNRF** (efektive per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2020).

Zbatimi i ketyre ndryshimeve ne standartet ekzistuese nuk ka cuar ne ndonje ndryshim material ne pasqyrat financiare te Deges.

2.7 Standarde dhe interpretime te publikuara, por akoma jo efektive

Ne daten e miratimit te ketyre pasqyrave financiare te vecanta, standardet, rishikimet dhe interpretimet e meposhtme ishin publikuar por akoma nuk ishin ne fuqi. Dega nuk ka zbatuar paraprakisht asnje nga standartet, rishikimet dhe interpretimet te cilat jane publikuar por akoma nuk ishin efektive.

Dega parashikon qe zbatimi i ketyre standardeve, ndryshimet ne standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja nuk do te kene ndikim ne pasqyrat financiare te Deges ne periudhen e zbatimit fillestar.

- **SNRF 17 "Kontratat e sigurimit"** perfshire permiresimet e SNRF 17 (efektive per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2023);
- **Ndryshimet ne SNRF 3 "Kombinimet e Biznesit"** – Reference e Kuadrit Konceptual me permiresimet e SNRF 3 (efektive per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2022);
- **Ndryshimet ne SNRF 4 "Kontratat e sigurimit"**– Zgjatje e Perjashtimeve te perkohshme nga zbatimi i SNRF 9 (data e mbarimit per perjashtimet e perkohshme nga SNRF 9 u zgjat ne periudha vjetore duke nisur ne ose pas 1 janar 2023);

2. BAZAT E PERGATITJES (VAZHDIM)

2.7 Standarde dhe interpretime te publikuara, por akoma jo efektive (vazhdim)

- **Ndryshimet ne SNRF 10 "Konsolidimi i pasqyrave financiare" dhe SNK 28 "Investimet ne Shoqerite dhe Sipermarkjet e Perbashketa"**- Shitja ose Kontributi i Aktiveve ndermjet nje investitori dhe bashkepunetorit te tij ose ndermarrjes se perbashket dhe ndryshimeve te metejshme (data efektive e shtyre per nje kohe te pacaktuar deri ne perfundimin e projektit kerkimor mbi metoden e kapitalit neto te perfunduar);
- **Ndryshimet ne SNK 1 "Paraqitja e pasqyrave financiare"** - Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata (efektive per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2023);
- **Ndryshimet ne SNK 16 "Aktive afatgjata materiale"** - Te ardhura para perdorimit te synuar (ne fuqi per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2022);
- **Ndryshimet ne SNK 37 "Provigjione, detyrime te kushtezuara dhe aktive te kushtezuara"** - Kontrata ne vazhdimesi - Kostoja e permbushjes se nje kontrate (efektive per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2022);
- **Ndryshimet ne SNRF 9 "Instrumentet Financiare", SNK 39 "Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja" dhe SNRF 7 "Instrumentet Financiare: Shenimet Shpjeguese" SNRF 4 "Kontratat e Sigurimit" dhe SNRF 16 "Qira"** - Reforma e Normes se Interesit baze (efektive per periudhat vjetore qe fillojne ne ose pas 1 janarit 2021);
- **Ndryshime ne standarde te ndryshme per shkak te "Permiresimeve te SNRF (cikli 2018 -2020)"** qe rezultojne nga projekti vjetor i permiresimit te SNRF (SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16 dhe SNK 41) kryesisht me qellim heqjen e mosperputhjeve dhe sqarimin e formulimeve (Ndryshimet ne SNRF 1, SNRF 9 dhe SNK 41 jane efektive per periudhat vjetore qe fillojne ne ose pas 1 janarit 2022. Ndryshimi ne SNRF 16 ka te beje vetem me nje shembull ilustrues, keshtu qe nuk deklarohet asnje date efektive).

Dega ka zgjedhur te mos zbatoje keto standarde te reja, ndryshimet ne standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja perpara dates kur behen efektive. Dega parashikon qe zbatimi i ketyre standardeve, ndryshimet ne standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja nuk do te kene ndikim ne pasqyrat financiare te Deges ne periudhen e zbatimit fillestar.

3. POLITIKA KONTABEL TE RENDESISHME

Politikat kontabel te meposhtme jane zbatuar ne menyre konsistente ne te gjitha periudhat e paraqitura ne keto pasqyra financiare.

3.1 Monedha e huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj perkthehen ne monedhen e raportimit dhe regjistrohen duke perdorur kursin e kembimit ne daten e transaksionit.

Aktivitet dhe detyrimet monetare te shprehura ne valuta te huaja perkthehen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e raportimit. Aktivitet dhe detyrimet jomonetare ne monedhe te huaj te

3. POLITIKA KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM)

3.1 Monedha e huaj (vazhdim)

matura me vleren e drejte konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlere e drejte. Zerat jomonetare te matur me koston historike te shprehur ne valute te huaj jane perkthyer me kursin e kembimit te dates se transaksionit. Diferencat ne valute te huaj pergjithesisht njihen ne fitim ose humbje.

Perkthimet ne monedhen e raportimit

Aktivitet dhe detyrimet e Deges perkthehen ne leke (monedha raportuese) me kursin e kembimit te dates se raportimit. Te ardhurat, shpenzimet dhe flukset monetare te Deges perkthehen ne leke me nje kurs kembimi mesatar te pershtatshem per periudhen. Diferencat nga perkthimi njihen ne te ardhura te tjera permbledhese dhe akumulohen ne rezerven e perkthimit.

3.2 Shpenzimet e kerkimit dhe vleresimit

(i). Kostot e para-licencimit

Kostot e para-licencimit ngarkohen ne periudhen ne te cilen kane ndodhur.

(ii). Kostot e blerjes se licences dhe pasurise

Licenca e kerkimit dhe kostot e blerjes kapitalizohen ne aktive jo-materiale.

Kostot e licences te paguara ne lidhje me te drejten per te eksploruar ne nje zone kerkimore ekzistuese kapitalizohen dhe amortizohen gjate afatit te lejes.

Licenca dhe kostot e blerjes se prones rishikohen ne çdo date raportimi per te konfirmuar se nuk ka asnje tregues qe vlere kontabel e tejkalon shumen e rikuperueshme. Ky rishikim perfshin konfirmimin qe shpimi i kerkimit eshte ende ne proces ose eshte planifikuar ne menyre te vendosur, ose se eshte percaktuar, ose po punohet per te percaktuar se zbulimi eshte ekonomikisht i qendrueshem bazuar ne nje sere konsideratash teknike dhe tregtare dhe se po behet perparim i mjaftueshem ne percaktimin e planeve zhvillimore dhe kohore.

Nese nuk planifikohet asnje aktivitet ne te ardhmen ose licenca eshte hequr ose ka skaduar, vlere kontabel e licences dhe kostot e blerjes se prones ngarkohen nepermjet pasqyres se fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera gjithepershireshe. Me njohjen e rezervave te vertetuara dhe miratimin e brendshem per zhvillim, shpenzimet perkatese transferohet ne pronat e naftes dhe gazit.

(iii). Kostot e kerkimit dhe vleresimit

Aktiviteti i kerkimit dhe vleresimit perfshin kerkimin e burimeve te naftes, percaktimin e fizibilitetit teknik dhe vleresimin e qendrueshmerise tregtare te nje burimi te identifikuar.

Pasi te jete fituar e drejta ligjore per te kerkuar, kostot qe lidhen drejtperdrejt me nje pus kerkimor kapitalizohen si aktive jomateriale te kerkimit dhe vleresimit derisa te perfundoje shpimi i pusit dhe te vleresohen rezultatet. Keto kosto perfshijne shperblimin e punonjesve qe i atribuohen drejtperdrejt, materialet dhe karburantin e perdorur, kostot e pajisjeve dhe pagesat e bera per kontraktoret. Interesat dhe kostot e tjera te financimit nuk kapitalizohen ne aktivet e kerkimit dhe vleresimit.

Kostot gjeologjike dhe gjeofizike njihen ne pasqyren e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera gjithepershireshe, kur ndodhin.

3. POLITIKA KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM)

3.2 Shpenzimet e kerkimit dhe vleresimit (vazhdim)

Nese nuk zbulohet asnje naftë potencialisht tregtare, aktivi i kerkimit ngarkohet permes pasqyres se fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera gjithëpërshiresë si një pus i thatë. Nese gjendet naftë e nxjerrshme dhe, duke iu nënshtruar aktivitetit te metejshe te vleresimit (p.sh., shpimi i puseve shtese), ka te ngjare qe ato te mund te zhvillohen komercialisht, kostot vazhdojne te mbahen si një aktiv jo-material nderkohe qe eshte bere perparim i mjaftueshem/vazhdues per te vleresuar tregtueshmerine e naftes. Kostot e lidhura drejtperdrejt me aktivitetin e vleresimit te ndermarre per te percaktuar madhesine, karakteristikat dhe potencialin tregtar te një rezervuari pas zbulimit fillestar te naftes, duke përshire kostot e vleresimit te puseve ku nafta nuk u gjet, fillimisht kapitalizohen si një aktiv jo-material.

Te gjitha keto kosto te kapitalizuara i nënshtrohen rishikimit teknik, tregtar dhe menaxherial, si dhe rishikimit per treguesit e zhvleresimit te pakten një here ne vit. Kjo eshte per te konfirmuar synimin e vazhdueshem per te zhvilluar ose ndryshe nxjerrjen e vleres nga zbulimi. Kur ky nuk eshte me rasti, kostot anulohen permes pasqyres se fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera gjithëpërshiresë.

(iii). Kostot e kerkimit dhe vleresimit

Kur identifikohen rezervat e vertetuara te naftes dhe zhvillimi vendoset nga drejtimi, shpenzimet perkatese te kapitalizuara fillimisht vleresohen per zhvleresim dhe (nese kerkohet) njihet çdo humbje nga zhvleresimi, me pas pjesa e mbetur transferohet ne pronat e naftes. Pervec kostove te licences, nuk ngarkohet amortizimi gjate fazes se kerkimit dhe vleresimit.

Zhvleresimi

Te drejtat dhe koncesionet ne lidhje me pronat e paprovuara te naftes dhe gazit vleresohen te pakten një here ne vit per te percaktuar nese ato jane te zhvleresuara kur vlerat kontabel te mbetura te tyre tejkalojne ekuivalentin e 20 milione USD ne baze te perspektives individuale, siç përshkruhet me poshte. Treguesit e zhvleresimit ne lidhje me te drejtat dhe koncesionet e paprovuara përshijne:

(a) aktivitetet e shpimit kerkues rezultojne ne një pus te thatë dhe nuk ka plane te metejshe per te shpuar ne ate vend; dhe

(b) skadimi i afatit te qirase eshte afer dhe asnje aktivitet shpimi nuk eshte zhvilluar ose eshte planifikuar te kryhet para skadimit.

Shuma e humbjes nga zhvleresimi qe do te njihej nese do te kryheshin rishikime individuale te zhvleresimit perafrohet duke amortizuar (zhvleresuar) ato te drejta dhe koncesione, individualisht, bazuar ne pervojen e meparshme te njesise ekonomike per situata te ngjashme dhe informacione te tjera te rendesishme, te tilla si kushtet paresore te qirase ae ketyre te drejtave dhe koncesioneve, periudha mesatare e mbajtjes se te drejtave dhe koncesioneve ne lidhje me vellimet e paprovuara (vellimet qe pritet te perbejne rezerva te provuara ne te ardhmen) dhe perqindjen relative te ketyre te drejtave dhe koncesioneve ne te cilat jane gjetur rezerva te provuara ne te kaluaren .

Ne fund te periudhes raportuese, manaxhimi i Deges ka vleresuar nese ka pasur ndonje fakt dhe rrethane qe sugjeron per një zhvleresim te aktivitetit te kerkimit dhe vleresimit dhe ka vendosur te zhvleresoje me tej aktivitetin e kerkimit dhe vleresimit ne lidhje me puse te veçanta te zhvleresuar gjate vitit 2019, per shkak te veshtiresive teknike.

3. POLITIKA KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM)

3.3 Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto, minus amortizimin dhe zhvleresimin e akumuluar. Kostoja perfshin shpenzimet qe lidhen drejtperdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve te ndertuara vete perfshin koston e materialeve dhe punes direkte, cdo kosto tjeter qe lidhet drejtperdrejt me sjelljen e aktivitet ne kushtet e punes per qellimin e synuar te perdorimit, si dhe koston e cmontimit, heqjes se pjeseve dhe sjelljes se vendndodhjes se aktivitet ne kushtet e tij te meparshme. Shpenzimet kapitale te aktiveve te kryera gjate ndertimit kapitalizohen ne “aktivet ne ndertim” dhe kalojne ne kategorine perkatese te aktivitet me perfundimin e ndertimit te tij, nga ku zbatohet edhe amortizimi perkates sipas kategorise se aktivitet. Ne rastet kur pjeset e makinerive, aktiveve afatgjata materiale kane jetegjatesi te ndryshme, ato llogariten si zera te ndryshem (perberes kryesore) te aktiveve afatgjata materiale. Aktivitet afatgjata materiale mbahen me pas me kosto minus amortizimin, shterimin dhe zhvleresimin e akumuluar. Fitimet dhe humbjet nga shitja ose asgjesimi i aktiveve percaktohen duke krahasuar te ardhurat me vleren kontabel te mbetur dhe njihen ne fitim ose humbje.

Njohja dhe matja (vazhdim)

Aktivitet afatgjata materiale te Deges perbehen nga kostot e projektimit, kryerjes dhe mbikqyrjes se punimeve te ndertimit ne zyrat e reja te marra me qira nga SUA ne katin e 6-te ne godinen ETC. Keto kosto jane kapitalizuar ne baze te permiresimeve te qirase te perdorura nga Dega per qellime administrative, per nje periudhe 20 mujore.

Kostot vijuese

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale njihet me vleren kontabel te atij zeri nese ka te ngjare qe shoqeria te gjeneroje perfitime ekonomike ne te ardhmen per me shume se nje vit nga perdorimi i pjeses zevendesuese dhe kostoja e pjeses mund te matet me besueshmeri. Kostot e sherbimeve te rregullta te aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzime ne periudhen kur ato ndodhin.

Amortizimi

Aktivitet afatgjata materiale ne parim amortizohen ne baze lineare gjate jetes se tyre te dobishme te vleresuar. Permiresimet e qirase amortizohen gjate periudhes me te shkurter midis jetes se tyre te dobishme te vleresuar dhe afatit te qirase. Vleresimet e jetegjatesise se dobishme dhe vlerave te mbetura te aktiveve afatgjata materiale dhe te aktiveve jo-materiale rishikohen cdo vit dhe rregullohen nese eshte e pershtatshme.

Jeta e dobishme e aktiveve afatgjata materiale, e perbere nga permiresime te prones me qira eshte 20 muaj, deri ne perfundimin e kontrates se qirase.

Zhvleresimi

Aktivitet afatgjata materiale testohen per zhvleresim dhe vleresohen nese ngjarjet ose ndryshimet ne rrethana tregojne se vlerat kontabel per ato aktive mund te mos jene te rikuperueshme. Gjithashtu jane rishikuar vlerat kontabel te aktiveve afatgjata materiale. Nese aktivet percaktohen te jene te zhvleresuara, vlerat kontabel te ketyre aktiveve reduktohen ne vleren e tyre te rikuperueshme, e cila eshte me e larta midis vleres se drejte minus kostot per shitje dhe vleres ne perdorim.

3. POLITIKAT KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM)

3.4 Instrumentat financiare

Dega mban vetem instrumenta financiare jo-derivative, te perbera nga llogari tregtare te arketueshme, mjete monetare dhe ekuivalente te tyre, fonde te marra nga Shoqeria Meme dhe te tjera llogari te pagueshme. Instrumentet financiare jo-derivative njihen me vleren e drejte plus cdo kosto transaksioni qe lidhet me blerjen e tyre.

Nje instrument financiar njihet nese Dega behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktivitetet financiare nuk njihen nese skadojne te drejtat kontraktuale te Deges mbi flukset e parase se aktiviteti financiar ose kur Dega transferon aktivitetin financiar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithesisht risqet dhe perfitimet thelbeshore te aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilen Dega angazhohet te bleje apo te shese aktivitetin. Detyrimet financiare nuk njihen nese detyrimet kontraktuale te Deges te detajuar ne kontrate, skadojne, paguhen ose anulohen. Pas njohjes fillestare, instrumentat financiare jo-derivative njihen sic pershkruhet me poshte.

3.4 Instrumentat financiare (vazhdim)

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to perfshijne mjetet monetare te mbajtura ne llogari bankare, te cilat nuk jane subjekt te ndonje risku te rendesishem ne ndryshimin e vleres se tyre te drejte dhe perdoren nga Dega ne menaxhimin e angazhimeve te saj afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre mbahen me koston e amortizuar.

Llogari te arketueshme

Llogaritja e arketueshme njihen fillimisht me vleren e drejte dhe ne vijim me kosto te pakesuara me humbjet nga renia ne vlere.

Llogari dhe te tjera te pagueshme

Llogaritja e pagueshme paraqiten me vleren e drejte dhe ne vijim me kosto te amortizuar.

Te tjera

Instrumentet e tjera financiare jo-derivative maten me kosto te amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv minus humbjet nga zhvleresimi. Metoda e interesit efektiv eshte nje metode per llogaritjen e koston se amortizuar te nje aktiviteti ose detyrimi financiar dhe per shperndarjen e te ardhurave ose shpenzimeve nga interesi gjate periudhes perkatese. Norma efektive e interesit eshte norma qe zbret plotesisht pagesat e ardhshme te vleresuara gjate jetes se pritshme te instrumentit financiar ose, kur eshte e pershtatshme, per nje periudhe me te shkurter ne vleren kontabel neto te aktivitetit ose detyrimit financiar. Kontabiliteti per te ardhurat dhe shpenzimet financiare eshte detajuar ne politiken kontabel 3.9.

Zhvleresimi i aktiveve financiare

Nje aktivitet financiar konsiderohet i zhvleresuar nese nje fakt objektiv tregon se nje ose me shume ngjarje kane pasur ndikim negativ ne flukset monetare te ardhshme te aktivitetit. Nje humbje nga zhvleresimi i nje aktiviteti financiar te matur me koston e amortizuar llogaritet si diferenca midis vleres neto dhe vleres aktuale te flukseve monetare te ardhshme te vleresuara te skontuara me normen fillestare te interesit efektiv.

3. POLITIKAT KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM)

3.4 Instrumentat financiare (vazhdim)

Aktivitetet financiare individualisht te rendesishme testohen per zhvleresim ne baza individuale. Aktivitetet financiare te mbetura vleresohen se bashku, ne grupe qe shfaqin te njejtat karakteristika te riskut te kredise. Te gjitha diferencat nga zhvleresimi njihen si fitim ose humbje. Humbja nga zhvleresimi rimerret nese rimarrja mund te lidhet ne menyre objektive me nje ngjarje qe ndodh pas njohjes se humbjes nga zhvleresimi. Rimarrja njihet ne pasqyren e fitimit ose humbjes.

Provisions

The Branch has not recognized any provision of decommissioning and restoration costs considering there is no legal obligation at the Exploration phase of the project based on the PSC, article 23.

3.5 Inventari

Inventari perfshin materiale dhe pjese kembimi te blera dhe mbajtura me qellim per t'u perdorur ne operacionet e kerkimit dhe vleresimit. Megjithate, bazuar ne politikat kontabel te zbatueshme, inventaret duhet te maten me vleren me te ulet mes kostos dhe vleres se realizueshme neto.

Kosto percaktohet duke perdorur metodën e mesatares se ponderuar. Vlera neto e realizueshme eshte cmimi i vleresuar i shitjes ne rrjedhen normale te biznesit minus kostot e vleresuara per perfundimin dhe realizimin e shitjes.

Kur materialet dhe pjeset e kembimit vihen ne perdorim, elementet perkates riklasifikohen si aktive kerkimi dhe vleresimi. Balanca e inventarit te naftes bruto qe rezulton nga aktivitetet e testimit te naftes eshte njohur me vleren e tregut ne daten e raportimit.

Bilanci i inventarit te naftes bruto qe rezulton nga aktivitetet e testimit te naftes eshte njohur me vleren e tregut ne daten e raportimit. Çdo reduktim i vleres se inventarit ne vleren e tij neto te realizueshme dhe te gjitha humbjet e inventarit njihen si shpenzim ne periudhen ne te cilen ndodh zhvleresimi ose humbja.

3.6 Qirate

Dega ka zbatuar SNRF 16 ne menyre retrospektive duke filluar nga 1 janari 2019 (periudha e pare ne te cilen standardi ka hyre ne fuqi). Zbatimi i SNRF 16 - Qirate ka patur nje ndikim ne shumat e njohura ne keto pasqyra financiare dhe ato te vitit 2019. Dega zbatoi SNRF 16 duke perdorur metodën retrospektive te modifikuar, duke perdorur mjetet praktike dhe duke zevendesuar te gjitha kerkesat e standardit te meparshem SNK17.

i. Perkufizimi i qirase

Dega ka vleresuar nese nje kontrate eshte ose permban nje qira bazuar ne perkufizimin e qirase, siç shpjegohet me poshte. Qiraja eshte nje kontrate ose pjese e nje kontrate, e cila i jep te drejten e perdorimit te nje aktivi (te aktivitetit baze) per nje periudhe kohore ne kembim te nje shume te caktuar.

Dega ka zbatuar SNRF 16 vetem per kontraten e qirase per zyren qendrore.

ii. Si qiramarres

Marreveshja e qirase e Degës lidhet me zyren qendrore dhe ploteson kriteret per t'u identifikuar si qira, per te cilen qiramarresi njej te drejten e perdorimit te aktivitetit. Kjo marreveshje lidhet me nje qira qe eshte e ndryshme nga qirate afatshkurtra dhe me vlere te ulet, prandaj Dega ka njohur nje aktiv te drejte perdorimi dhe detyrimin perkates te qirase.

3. POLITIKAT KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM)

3.6 Qirate (vazhdim)

iii. Ndikimi ne pasqyrat financiare

Nje kontrate eshte, ose permban, nje qira nese kontrata percjell te drejten per te kontrolluar perdorimin e nje aktivi te identifikuar per nje periudhe kohe. Per te vleresuar nese nje kontrate percjell te drejten per te kontrolluar perdorimin e nje aktivi te identifikuar, Dega perdor perkufizimin e qirase ne SNRF 16. Kjo politike zbatohet per kontratat e lidhura, ne ose pas 1 janarit 2019.

Me fillimin ose me modifikimin e nje kontrate qe permban nje komponent te qirase, Dega shperndan vleresimin ne kontrate per secilin perberes te qirase ne baze te cmimeve specifike.

Dega njeh nje drejte perdorimi te aktivitetit dhe nje detyrim te qirase ne daten e fillimit te qirase. Aktiviteti me te drejte perdorimi fillimisht matet me koston, e cila perfshin shumen fillestare te detyrimit te qirase te rregulluar per çdo pagese te qirase te bere ne ose pas dates se fillimit, pasi nuk ka patur kosto fillestare direkte te ndodhur ose stimul qiraje te marre.

E drejta e perdorimit te aktivitetit zhvleresohet me pas duke perdorur metoden lineare nga data e fillimit deri ne fund te afatit te qirase, pervec nese qiraja transferon pronesine e aktivitetit baze tek Dega deri ne fund te afatit te qirase ose kostoja e aktivitetit te se drejtes se perdorimit pasqyron qe Dega do te ushtroje nje opsion blerjeje. Ne kete rast, e drejta e perdorimit te aktivitetit do te zhvleresohet gjate jetes se dobishme te aktivitetit baze, i cili percaktohet ne te njejten baze si ato te pasurive dhe pajisjeve. Per me teper, e drejta e perdorimit te aktivitetit zvogelohet ne menyre periodike nga humbjet e zhvleresimit, nese ka, dhe rregullohet per rivleresime te caktuara te detyrimit te qirase.

Detyrimi i qirase fillimisht matet me vleren aktuale te pagesave te qirase, te cilat nuk jane paguar ne daten e fillimit, skontuar me normen e interesit te percaktuar nga Dega duke u bazuar ne te dhenat e disponueshme sipas Bankes se Shqiperise.

Dega percakton normen e saj ne rritje te huamarrjes duke marre normat e interesit nga burime te ndryshme te jashtme te financimit dhe kryen rregullime te caktuara per te pasqyruar kushtet e qirase dhe llojin e aktivitetit te dhene me qira.

Pagesat e qirase perfshijne ne llogaritjen e detyrimit te qirase si me poshte:

- pagesat fikse perfshire pagesat fikse ne thelb;
- pagesat variabel te qirase te cilat varen nga nje indeks ose norme, e matur fillimisht duke perdorur nje indeks ose norme ne daten e fillimit;
- shumat qe pritet te paguhen nen nje garanci te vleres se mbetur; dhe
- çmimi i ushtrimit te nje opsioni blerjeje nese Dega eshte mjaft e sigurt per ta ushtruar kete opsion, pagesa te qirase ne nje periudhe rinovimi opsionale nese Dega eshte e sigurt per te ushtruar nje mundesi shtese, dhe gjoba per perfundimin e parakohshem te qirase pervec nese Dega eshte ka siguri te arsyeshme qe te mos e nderprese heret.

Detyrimi i qirase matet ne baze te koston se amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Raporti i ecurise se veprimtarise eshte pergatitur ne perputhje me nenin 17 te Ligjit nr. 25/2018 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ne fuqi nga 1 janari 2019.

Pershkrimi i shoqerise

Shell Upstream Albania B.V. – Dega ne Shqiperi (referuar ketej e tutje si "SUA") eshte dege e Shell Upstream Albania B.V., themeluar ne Hollande (referuar si "Shell" ose "Shoqeria"), filial i shoqerise shumekombeshe te naftes dhe gazit Royal Dutch Shell plc (referuar si "RDS"). Dega eshte regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, me 7 qershor 2012, ne perputhje me Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", me numer unik identifikimi tatimor (NUIS/NIPT) L21807009I. Numri i punonjesve te Deges me 31 dhjetor 2020 eshte 56 (31 dhjetor 2019: 65).

Aktiviteti kryesor i Deges eshte shpimet ne kerkim te hidrokarbureve ne Shqiperi. Me 9 shkurt 2012, Shell Upstream Albania B.V. hyri ne Shqiperi duke marre 50% te interesit pjesmarres nepermjet nje marreveshje transferimi dhe marreveshje operimi te perbashket te Kontrates me Ndarje Prodhimi ("KNP") per Blloqet 2-3 ne Shqiperi, ne ate kohe nen operim nga Petromanas Albania GmbH (PMI) nepermjet nje dege te regjistruar ne Shqiperi. Me 20 qershor 2013, Shell dhe Petromanas Albania GmbH nenshkruan nje shtese te marreveshjes se transferimit per KNP-ne per Blloqet 2-3 ne Shqiperi, marreveshje e lidhur fillimisht mes paleve ne shkurt 2012. Kjo shtese i siguroi Shell nje interes shtese prej 25%. Shell mori ne zoterim 100% te interesave ne 1 mars 2016 pas blerjes se 25% te interesave te mbetur nga Petromanas Albania GmbH dhe, si rrjedhoje e ketij procesi, mori rolin e Operatorit per Blloqet 2-3. Operacionet e shpimit ne pusin Shpirag-3 filluan ne 5 qershor 2016 ne perputhje me kerkesat e KNP-se. Operacionet e shpimit ne pusin Shpirag-3 u nderprene ne dhjetor 2017, rifilluan ne korrik 2019 dhe u pezulluan perfundimisht ne nentor 2019. Ne janar 2018, Dega filloi operacionet ne pusin Shpirag-4. Ne shkurt 2018, Shell ka nenshkruar me qeverine shqiptare KNP-ne per Bllokun 4, ne jug te Blloqeve 2-3, te miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave nr. 350, date 12 qershor 2018. Ne 18 korrik 2019, SUA transferoi 100% te interesit ne KNP-ne per Bllokun 4 te nje filial tjetere i Royal Dutch Shell plc, Shell Albania Block 4 B.V.- Dega ne Shqiperi (SAB 4). Akti i Transferimit u be efektive ne 6 shtator 2019, kur SUA transferoi te SAB 4 edhe pjesen e saj te aktivitetit ekonomik qe lidhet me operacionet e KNP-se per Bllokun 4. SUA ka vazhduar te operoje si zakonisht KNP-ne per Blloqet 2-3, para dhe pas transferimit te aktivitetit ekonomik te pjesshem te SAB 4.

Gjate vitit 2019, KNP per Blloqet 2-3 u ndryshua dhe riformulua nga Qeveria Shqiptare dhe SUA. KNP e ndryshuar dhe e riformeluar per Blloqet 2-3 u miratua nga Keshilli i Ministrave te Shqiperise ne shkurt 2020.

Analiza e performances

Analiza e performances duhet te lexohet dhe kuptohet ne perputhje me pasqyrat financiare te SUA, te firmosura dhe te dorezuara per publikim ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Per shkak te faktit se SUA eshte ende ne fazen e kerkimit hidrokarbur dhe nuk ka prodhim, matja e efektivitetit dhe fitimprurjes nuk eshte relevante. Per me teper, per faktin se SUA eshte nje dege e Grupit Shell, te gjitha aktivitetet financohen nga shoqerite meme dhe nje sasi e konsiderueshme e sherbimeve dhe materialeve te perdorura vijne nga shoqerite pale te lidhura, zbatimi i raporteve/treguesve tipike te pasqyres se pozicionit financiar mund te bejne pozicionin financiar te entitetit te duket me pak i qarte. Per te kuptuar me mire gjendjen financiare te entitetit, u zgjedhen disa nga vlerat kryesore financiare qe lidhen me vitet 2019 dhe 2020 (vlerat e 2019 jane ripercaktuar per shkak te aplikimit te IFRS-ve).

ANALIZA E PERGJITHSHME (VAZHDIM)

(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije leke)

2020

2019

PASQYRA E PERFORMANCES FINANCIARE - VLERAT KYÇE

Te ardhurat	20,226	9,030
Totali i shpenzimeve operative	(4,510,065)	(3,406,861)
Zhvleresimi i puseve	(131,005)	(23,760,093)
(Humbja)/fitimi financiar neto	80,167	(220,584)
Humbja e vitit	(4,540,677)	(27,378,508)

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR - VLERAT KYÇE

Aktive kerkimi dhe vleresimi	24,876,199	26,559,302
Fonde nga shoqeria meme	60,352,740	59,590,212
Detyrime te perlllogaritura ndaj paleve te lidhura	12,509,356	10,878,844
Humbje te mbartura + humbja e vitit	(45,832,089)	(44,485,314)

Vlerat e prezantuara me lart jane te bazuara ne pasqyrat financiare te pergatitura ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar.

Bazuar ne vlerat kryesore te mesiperme, eshte e qarte se fonde te konsiderueshme u investuan ne operacionet e kerkimit dhe zhvillimit te hershem ne vitet 2018 dhe 2019. Te gjitha fondet e shpenzuara ne investime kapitale lidhen me shpimet e dy puseve: Shpirag 3 dhe Shpirag 4. Te gjitha shpenzimet e tjera jane te lidhura me fushat e aktiviteteteve qe mbeshtesin punen kerkimore.

Nje tjetër operacion domethenes qe ndodhi ne vitin 2019 eshte nje zhvleresim ne vleren 23,760,093 mije leke. Zhvleresimi ka te beje me nje rishikim te zhvleresimit ne fund te periudhes raportuese te dy puseve, Molisht-1 dhe Shpirag-3, per shkak te disa veshtiresive te caktuara teknike te hasura gjate eksplorimit dhe vleresimit. Si rezultat, vlera kontabel e ketyre njesive gjeneruese te parase eshte zhvleresuar plotesisht.

Nuk ka patur aktivite te rendesishme te ndodhura gjate vitit 2020.

Risqet e identifikuara

Faktore te jashtem te riskut

Risqet makroekonomike duke perfshire luhatjen e çmimeve te naftes se paperpunuar dhe te produkteve te naftes.

Çmimet e naftes se paperpunuar, gazit natyror, produkteve te naftes dhe kimikateve ndikohen nga oferta dhe kerkesa, si ne rang global ashtu edhe rajonal. Per me teper, risqet makroekonomike mund te ndikojne ne kerkesen per produktet tona. Faktoret qe ndikojne ne oferte dhe kerkese perfshijne çeshtje operative, fatkeqesi natyrore, kushtet klimaterike, pandemite, siç eshte shperthimi i COVID-19 (coronavirus), paqendrueshmeria politike, konfliktet, kushtet ekonomike dhe veprimet

ANALIZA E PERGJITHSHME (VAZHDIM)

Risqet e identifikuara (vazhdim)

nga shtetet kryesore prodhuese te naftes dhe gazit. Periudhat e tejzgjatura te çmimeve te uleta te naftes dhe gazit, ose rritja e kostove, mund te rezultojne ne projektet qe shtyhen ose anulohen dhe aktive qe zhvleresohen.

Per te zbutur riskun, pergatiten planet strategjike dhe financiare vjetore. Planet konsiderojne dhe analizojne ndikimin e skenareve te ndryshem te çmimeve ne bizneset dhe shoqerine tone ne teresi. Keto plane vleresohen rregullisht gjate gjithë vitit. Ekziston gjithashtu qellimi per te mbajtur nje pozicion financiar te konsoliduar per te siguruar qendrueshmeri ndaj çmimeve te dobeta te tregut.

Risku i saktësisë së supozimeve mbi çmimet

Shoqeria perdor nje game te supozimeve mbi çmimin e naftes dhe gazit, te cilat shoqeria i rishikon ne menyre periodike, per te vleresuar projektet dhe mundesite tregtare. Nese supozimet tona deshmojne te jene te pasakta, mund te kete nje efekt negativ material ne te ardhurat, flukset e mjeteve monetare dhe gjendjen financiare.

Per te zbutur riskun, gama e çmimeve te mallrave te perdorura ne projektin dhe vleresimet tona te portofolit eshte subjekt i nje vleresimi rigoroz te treguesve afatshkurter, afatmesem dhe afatgjate te tregut.

Risku i forcave te konkurences

Shoqeria perballet me konkurrence ne biznesin e saj. Shoqeria eshte duke konkurruar ne tregjet e mallrave thelbesore. Prandaj, deshtimi per te menaxhuar kostot e shoqerise si dhe performancen operacionale mund te rezultojne ne nje efekt negativ material ne te ardhurat, flukset e mjeteve monetare dhe gjendjen financiare. Shoqeria konkuron gjithashtu me njesite shteterore te naftes dhe gazit me qasje ne burime te medha financiare. Nese shoqeria nuk eshte ne gjendje te siguroje kthime konkurruese ne tenderat per qirate ose projektet e reja, kjo mund te kete nje efekt negativ material ne te ardhurat, flukset e mjeteve monetare dhe gjendjen financiare.

Per te zbutur riskun shoqeria vlereson vazhdimisht mjedisin e jashtem - tregjet dhe nxitesit themelore ekonomike, politike, sociale dhe mjedisore qe i formesojne ato - per te vleresuar ndryshimet ne forcat konkurruese dhe modelet e biznesit. Shoqeria perdor skenare te shumte te te ardhmes per te vleresuar qendrueshmerine e strategjise se saj.

Risku i klimes/mjedisit

Shqetesimet ne rritje per ndryshimet klimaterike kane çuar dhe mund te çojne ne masa shtese ligjore dhe/ose rregullatore qe mund te rezultojne ne shtyrje ose anulime te projekteve, ne ulje te kerkeses per lende djegese fosile, procese gjyqesore te mundshme dhe detyrime shtese te pajtueshmerise.

Ne dhjetor 2015, 195 vende, perfshire Shqiperine, miratuan Marreveshjen e Parisit. Si rezultat, Shoqeria pret vemendje te vazhdueshme dhe te rritur ndaj ndryshimeve klimaterike nga te gjithë sektoret e shoqerise. Kjo vemendje ka çuar, dhe pritet te çojë, ne krijimin e rregulloreve shtese per te zvogeluar emetimet e gazit sere. Pritet qe nje rritje e pjeses se emetimeve

ANALIZA E PERGJITHSHME (VAZHDIM)

Risqet e identifikuara (vazhdim)

te gazit sere te behet subjekt i rregullave, duke rezultuar ne rritjen e kostove te pajtueshmerise dhe kufizimeve operacionale.

Risku monitorohet dhe rishikohet ne menyre aktive. Keto rishikime te rregullta çojne ne veprime te dizajnuara per te adresuar te gjithë perberesit e ndryshem te riskut.

Risqet e mjedisit te jashtem

Keto risqe prekin njerezit dhe pasurite. Risqet e mundshme perfshijne: aktet e terrorizmit; aktet e kriminalitetit; spiunazhi kibernetik ose sulmet shkaterruese kibernetike; konfliktet perfshire luften, trazirat civile dhe aktivizmin mjedisor dhe klimaterik (perfshire nderprerjet nga organizatat joqeveritare dhe politike); dhe semundjet pandemike, siç eshte shperthimi i COVID-19 (coronavirus).

Risqet e mesiperme mund te kercenojne funksionimin e sigurt te objekteve tona dhe transportimin e produkteve tona, te shkaktojne nderprerje te aktiviteteve operacionale, demtim te mjedisit, humbje te jetes, lendime dhe te ndikojne ne mireqenien e njerezve tane.

Keto risqe mund te kene nje efekt negativ material ne te ardhurat tona, flukset e mjeteve monetare dhe gjendjen financiare. Per te zbutur keto risqe, Shoqeria kerkon te marre informacionin me te mire te mundshem per te mundesuar vleresimin e kercenimeve dhe risqeve.

Risku i shendetit, sigurise dhe mjedisit

Risqet e shendetit, sigurise dhe mjedisit ('HSSE') ndaj te cilave ne dhe komunitetet ne te cilat shoqeria punon jemi potencialisht te ekspozuar, mbulojne ne nje spekter te gjere, duke pasur parasysh diversitetin operacional dhe kompleksitetin teknik te operacioneve tona. Keto risqe perfshijne efektet e fatkeqesive natyrore (perfshire ngjarjet klimaterike), termetet, trazirat sociale, shendetin personal dhe gabimet e sigurise, si dhe krimin. Nese nje risk i madh materializohet, siç eshte nje shperthim ose rrjedhje hidrokarbure, kjo mund te rezultojë ne demtime, humbje jete, deme mjedisore, prishje te aktiviteteve te biznesit dhe humbje ose pezullim te licences sone per te operuar ose te drejtes per te dhene oferten tone ne tenderat per te drejtat minerale. Prandaj, kjo mund te kete nje efekt negativ material ne te ardhurat tona, flukset e mjeteve monetare dhe gjendjen financiare.

Operacionet e shoqerise jane subjekt i kerkesave te gjera rregullatore te HSSE qe shpesh ndryshojne dhe ka te ngjare te behen me te rrepta me kalimin e kohes. Shoqeria mund te kryejë shpenzime te konsiderueshme shtese ne te ardhmen per shkak te pajtueshmerise me keto kerkesa ose si rezultat i shkeljeve te, ose detyrimeve te parashikuara nga ligjet dhe rregullore, siç jane gjobat, penalitetet, kostot e pastrimit dhe pretendimet e paleve te treta. Prandaj, risqet e HSSE, nese ato materializohen, mund te kene nje efekt negativ material ne te ardhurat tona, flukset e parave dhe gjendjen financiare.

Per te zbutur riskun, si nje entitet i Grupit Shell, shoqeria ka standarde dhe nje strukture te qarte qeverisjeje per te ndihmuar ne menaxhimin e ndikimeve te mundshme. Ato jane te percaktuara ne kornizen tone te kontrollit te Shendetit, Sigurise, Mjedisit dhe Performances Sociale dhe dokumenteve udhezuese mbeshtetese. Shoqeria pergatit dhe praktikon ne menyre rutine reagimin tone urgjent ndaj incidenteve te mundshme siç jane nje rrjedhje ose nje zjarr.

ANALIZA E PERGJITHSHME (VAZHDIM)

Risqet e identifikuara (vazhdim)

Risku ligjor dhe rregullator

Çdo shkelje e ligjeve dhe rregulloreve që aplikohen për SUA ose çdo dëmtim i reputacionit të kompanisë mund të ketë një efekt negativ material në të ardhurat, flukset e mjeteve monetare dhe gjendjen financiare.

Për të zbutur riskun, shoqëria ka një ekip të perkushtuar për të siguruar përputhjen e plotë me ligjet ekzistuese.

Risku financiar

Risku financiar është përfshirë dhe përshkruar në seksionin e instrumentave financiare.

Faktore të brendshme të riskut

Kompleksiteti i projektit të zhvillimit.

Shoqëria përballë me sfida të shumta në zhvillimin e projekteve të kapitalit, të cilat janë të mëdha dhe të integruara. Sfidat përfshijnë: gjeologji të pasigurt; kushtet e kufitura; ekzistencën dhe disponueshmërinë e teknologjisë dhe burimeve të nevojshme inxhinierike; disponueshmëria e forcës punëtore të kualifikuar; ekzistenca e infrastrukturës së transportit; vonesat e projektit; skadimi i licencave; tejkalimi i mundshëm i kostove; dhe kushtet teknike, fiskale, rregullatore, politike dhe kushte të tjera. Shoqëria mund të deshtëjë në vlerësimin ose menaxhimin e duhur të ketyre dhe risqeve të tjera. Përgesja e tillë të mundshme mund të demtojë kryerjen e ketyre projekteve, aftësinë e shoqërisë për të arritur vlerën e mundshme të përcaktuar në kohën e miratimit të investimit të projektit, dhe/ose aftësinë të kompanisë për të përmbushur angazhimet kontraktuale përkatëse. Këto faktore mund të çojnë në zhvlerësime dhe mund të kenë një efekt negativ material në të ardhurat të kompanisë, flukset e mjeteve monetare dhe gjendjen financiare.

Për të zbutur riskun, shoqëria përdor nndarjen, projektin dhe ekspertizën teknike dhe menaxhon në mënyrë aktive risqet jo-teknike. Kjo kryhet me një qasje të integruar ku në përdorim një numër teknikash konkurruese përmes të cilave përcaktojmë qasjen të brendshme dhe të jashtme.

Risku i teknologjisë së informacionit

Shoqëria mbështetet shumë në sistemet e teknologjisë së informacionit në operacione.

Ndërprerja e shërbimeve kritike të teknologjisë së informacionit, ose shkeljet e sigurisë së informacionit, mund të demtojë reputacionin të kompanisë dhe të kenë një efekt negativ material në të ardhurat, flukset e mjeteve monetare dhe gjendjen financiare. Për të zbutur Riskun, shoqëria vazhdimisht mat dhe përmirëson aftësitë të kompanisë të sigurisë kibernetike.

ZHVILLIME TË MUNDSHME TË ARDHSHME

Gjatë vitit 2020, operacionet direkte në kantierë u pezulluan për të kryer analizë të detajuarë të të dhënave të mbledhura gjatë fazave të kryera. Në bazë të ketyre analizave u krijua plani operacional për vitet e ardhshme.

ZHVILLIME TE MUNDSHME TE ARDHSHE (VAZHDIM)

Planet e aktiviteve te ardhshme perfshijne:

- Operacione te metejshme mbi pusin Shpirag 4;
- Shpimi i nje pusi te ri Shpirag 5;
- Vleresim te metejshem te te dhenave sizmike ekzistuese (rajonale).

AKTIVITETE NE FUSHEN E KERKIMIT DHE ZHVILLIMIT

Nuk ka pasur aktivite ne fushen e kerkimit dhe zhvillimit ('R&D') gjate vitit 2020.

INFORMACIONE PER MARRJEN E AKSIONEVE TE VETA

SUA eshte dega e Shell Upstream Albania B.V. e themeluar ne Hollande, filial i shoqerise shumekombeshe te naftes dhe gazit Royal Dutch Shell plc. Pronar i drejtperdrejte i 100% aksioneve te Shell Upstream Albania B.V. eshte Dordtsche Petroleum Maatschappij B.V. e themeluar ne Hollande.

Nuk ka pasur ndryshime ne strukturen e kapitalit gjate vitit te raportuar.

EKZISTENCA E DEGEVE

SUA nuk ka asnje filial ose dege.

PERDORIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

SUA nuk ka perdorim te instrumenteve komplekse financiare. Zerat financiare me vlere domethenese jane:

- Mjetet monetare
Shumica e mjeteve monetare te mbajtura nga SUA mbahen ne Dollar Amerikan (USD) ne formen e nje llogarie te perbashket me gjendje te gatshme per perdorim. Mjetet monetare ne EUR dhe leke mbahen ne llogari bankare vendase.
- Fonde te marra nga shoqeria meme
Fondet e marra nga shoqeria meme perbehen nga nje financim afatgjate pa interes dhe rrjedhin pjeserisht nga nje kredi pa interes nga nje pale e lidhur per shoqerine meme dhe pjeserisht nga primi i aksioneve te kontribuar nga aksionari i shoqerise meme tek shoqeria meme.

Si nje dege e Grupit Shell, standardet globale te thesarit te Shell jane te zbatueshme per SUA. Keto politika perfshijne: strukturen e financimit; administrimin e riskut te normes se interesit dhe te kembimit valutor; sigurimin; menaxhimin e riskut te paleve; dhe perdorimin e kontratave derivative.

Risku i normes se interesit

I gjithe detyrimi vjen nga Shell Group, dhe per kete arsye nuk ka ndonje risk te drejtperdrejte te normes se interesit per SUA.

PERDORIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE (VAZHDIM)

Risku i kembimit valutor

Fitimet dhe humbjet e kembimit valutor linden ne rrjedhen normale te biznesit nga njohja e arketimeve dhe detyrimeve te pagueshme dhe njesive te tjera monetare ne monedha te ndryshme nga monedha funksionale e nje njesie ekonomike. Risku i kembimit valutor gjithashtu mund te linden ne lidhje me shpenzimet kapitale. Per projektet kryesore brenda Grupit Shell, ne fazen e fundit te vendimit per investimet behet nje vleresim nese duhet te mbrohet nga ndonje ekspozim qe mund te rezultojte.

Pjesa me e madhe e transaksioneve behet ne dollare, keshtu qe ekspozimi me i madh ndaj riskut te kursit te kembimit eshte ne kursin e kembimit USD/ALL.

Risku i kredise

Politikat e zbatueshme sigurojne qe shitjet e produkteve t'u behen klienteve me besueshmeri te pershtatshme. Per SUA, e cila eshte nje entitet kerkimi ne fazat e para, kjo nuk eshte aktualisht e zbatueshme, por do te jete kur te filloje prodhimi.

Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit eshte risku qe burimet e pershtatshme te financimit per aktivitetet e biznesit te Shell-it mund te mos jene te disponueshme. Te gjitha fondet per SUA vijne nga Grupi Shell, dhe per kete arsye nuk ka ndonje risk te drejtperdrejte per te humbur likuiditetin.

10.11.2021

Miraturar nga:

Anthonie Marinus Frens, Administrator

Shell Upstream Albania B.V. – Dega ne Shqiperi



**RAPORTI I DREJTIMIT TE BREND SHEM
PER VITIN FINANCIAR MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2020**

PERMBAJTJA

RREGULLAT/KODET/PRAKTIKAT E DREJTIMIT TE BREND SHEM	3
SISTEMI I KONTROLLIT TE BREND SHEM DHE MANAXHIMI I RISKUT NE LIDHJE ME RAPORTIMIN FINANCIAR	5
PERBERJA DHE FUNKSIONIMI I ORGANEVE EKZEKUTIVE DREJTUESE DHE MBIKEQYRESE DHE TE KOMITETEVE TE TYRE	6
POLITIKA TE NDRYSHME TE ZBATUARA LIDHUR ME ORGANET EKZEKUTIVE DREJTUESE DHE MBIKEQYRESE	7

RREGULLAT/KODET/PRAKTIKAT E DREJTIMIT TE BRENDSDHEM

Ky raport i drejtimit te brendshem eshte pergatitur ne perputhje me nenin nr. 19 te Ligjit nr. 25/2018 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", efektiv qe nga 1 janari 2019.

Parimet kryesore

Shell Upstream Albania B.V. – Dega ne Shqiperi (referuar ketej e tutje si "SUA" ose "Dega" ose "Shoqeria") eshte dege e nje filiali te shoqerise shumekombeshe te naftes dhe gazit Royal Dutch Shell plc ("Grupi Shell"). Shoqeria meme e grupit Shell eshte Royal Dutch Shell plc, e cila eshte themeluar ne Angli dhe Uells. Te gjitha rregulloret e brendshme te korporates te perdorura ne Grupin Shell jane gjithashtu te zbatueshme per SUA. Parimet e Pergjithshme te Biznesit te Shell bazohen ne vlerat thelbesore te sinqeritetit, integritetit dhe respektit per njerezit dhe jane pjese e gjithckaje qe Shoqeria ben. Ato vlejne per te gjitha punet e biznesit te Shell dhe pershkruajne sjelljen e pritshme te cdo punonjesi.

Dokumentet kryesore te lidhura me etiken dhe pajtueshmerine, te gjitha te miratuara nga organet e autorizuar te Royal Dutch Shell plc, jane:

- Kodi i Sjelljes. Kodi i Sjelljes i Shell udhezoi punonjesit se si te zbatojne Parimet e Pergjithshme te Biznesit te Shell ne perputhje me vlerat thelbesore.
- Manuali i Etikes dhe Pajtueshmerise. Manuali i Etikes dhe i Pajtueshmerise i Shell percakton perkushtimin e Shell ndaj Etikes dhe Pajtueshmerise (E&P).
- Kodi i Etikes. Kodi i Etikes pershkruan kerkesat per nenpunesit tane kryesore ekzekutive dhe nenpunesit e larte financiare.

Kodi i Sjelljes i Shell se bashku me Manualin e Pajtueshmerise udhezoi punonjesit se si te zbatojne Parimet e Pergjithshme te Biznesit te Shell ne perputhje me vlerat thelbesore. Te gjithe punonjesit dhe kontraktoret e Shell pritet te kuptojne dhe te sillen vazhdimisht ne perputhje me Parimet e Biznesit te Shell. Shoqeria pret qe furnitoret, dhe sipermarrjet e perbashketa (joint ventures) qe nuk operohen nga Shell, te zbatojne parime ekuivalente.

Kodi i Sjelljes i Shell mbeshket cdo punonjes, personel kontraktor dhe kontraktues qe punon per ose ne emer te Shell. Ai percakton sjelljet e pritura prej punonjesve tane dhe menyren se si ato lidhen me Parimet tona te Biznesit dhe Vlerat Thelbesore.

Manuali i Etikes dhe Pajtueshmerise i Shell mbeshketet ne Parimet e Pergjithshme te Biznesit te Shell dhe Kodin e Sjelljes se Shell per te ofruar keshilla praktike se si te respektohen ligjet dhe rregulloret dhe si te jene ne marredhenie me klientet, komunitetet dhe koleget. Manuali i Etikes dhe Pajtueshmerise ofron udhezime te hollesishme per te qenurit ne perputhje, duke ndihmuar personelin tone te beje gjene e duhur cdo dite.

Praktikat e burimeve njerezore

Praktikat e burimeve njerezore (BNJ) te perdorura brenda Grupit Shell jane shume mire te rregulluara, me fokus ne fusha te tilla si:

- Diversiteti dhe perfshirja
- Etika dhe pajtueshmeria

Praktikat e burimeve njerezore te zbatuara nga SUA jane ne perputhje me Kodin e Punes se Shqiperise dhe legjislacionin tjeter te zbatueshem.

RREGULLAT/KODET/PRAKTIKAT E DREJTIMIT TE BRENDSEM (VAZHDIM)

Praktikat e burimeve njerezore (vazhdim)

Çdo punonjes ka akses ne mjetet e BNJ qe lejojne shtrimin e pyetjeve dhe shqetesimeve, si dhe ankesave. Ekzistojne rregulla te rrepta per te siguruar qe te gjitha kerketat e tilla do te trajtohen seriozisht dhe te hetohen thellesisht. Qasja eshte e lidhur drejtperdrejt me Parimet e Pergjithshme te Biznesit te Shell dhe Kodin e Sjelljes.

Bazuar ne rregullat e brendshme te Grupit Shell, te gjitha punonjesit kane mundesi te rrisin njohurite dhe aftesite e tyre duke marre pjese ne nje game te gjere trajnimesh online dhe tradicionale. Pervec trajnimeve te ofruara, ekzistojne dhe disa praktika te mira ne lidhje me shkembimin e njohurive te brendshme.

Praktikat kunder korrupsionit dhe pastrimit te parave

Ne perputhje me Parimin Global te Kombeve te Bashkuara 10 (Bizneset duhet te punojne kunder korrupsionit ne te gjitha format e tij, duke perfshire zhvatjen dhe ryshfetin), Shell mban nje program global kunder ryshfetit dhe korrupsionit/pastrimit te parave ('ABC/AML') i krijuar per te parandaluar ose zbuluar shkeljet e mundshme, si dhe per te permiresuar dhe mesuar prej tyre. Programi mbeshtetet nga angazhimi yne per te ndaluar ryshfetin, pastrimin e parave dhe evazionin tatimor dhe per te kryer biznes ne perputhje me Parimet tona te Pergjithshme te Biznesit dhe Kodit te Sjelljes se Shell.

Programet kunder ryshfetit dhe korrupsionit/kunder pastrimit te parave (ABC/AML) qe zbatohen nga SUA jane gjithashtu ne perputhje me legjislacionin perkates ne Shqiperi.

Politika jone eshte e qarte: ne nuk tolerojme oferte te drejteperdrejte ose jo te drejteperdrejte, pagese, kerkese ose pranim te ryshfeteve ne çfaredo forme. Pagesat avantazhuese jane gjithashtu te ndaluara. Kodi yne i Sjelljes perfshin udhezime specifike per stafin, te tilla si kerkesa per te deklaruar ose shmangur konflikte te mundshme te interesit, dhe te tjera qe kane te bejne me oferten ose pranimin e dhuratave dhe mikpritjen. Komunikimet nga drejtuesit perfshijne mesazhe ne lidhje me keto angazhime dhe kerketat perkatese. Keto jane te perforcuara si me komunikimet globale ashtu dhe me ato te veçanta, per te siguruar qe personeli te rikujtohet vazhdimisht per detyrimet e tyre.

Pervec Kodit te Sjelljes, Shell ka krijuar procedura dhe kontrole te detyrueshme kunder ryshfetit te zbatueshme per te gjitha Bizneset dhe Funksionet e Shell, pergjate operacioneve te tyre. Procedurat dhe kontrollet jane krijuar per te adresuar nje sere rreziqesh te lidhura me korrupsionin dhe per te perqendruar burimet dhe vemendjen ne fushat me risk me te larte. Shoqeria rregullisht rishikon dhe ripunon keto procedura, kontrole dhe kriteret e riskut per te siguruar qe ato jane te perditesuara me ligjet, rregulloret dhe praktikat me te mira ne fuqi. Rishikimet tona te programit marrin ne konsiderate gjithashtu rezultatet e auditimeve te brendshme, rishikimeve dhe hetimeve perkatese.

Si pjese e qasjes sone ndaj trajnimit te etikes dhe pajtuesmerise, Shell ndermerr veprime per te siguruar qe politikat tona kunder korrupsionit, standardet, dhe procedurat jane komunikuar te te gjitha drejtoret, pergjegjesit, punonjesit, dhe, kur eshte e nevojshme dhe e pershtatshme, te agjentet dhe partneret e biznesit. Fusha te fokusit te veçante ne lidhje me palet e treta perfshijne forcimin e vazhdueshem te procedurave te kujdesit te duhur, dhe kerketat e artikuluara qartesisht (per shembull permes perdorimit te klauzolave standarde te kontrates).

Kerketat per keshilla ose raportim te shqetesimeve mund te dorezohen permes Shell Global Helpline ose nepermjet kanaleve te brendshme, sikurse dhe kerkesa te tjera ose shqetesime qe lidhen me Kodin e Sjelljes ose Parimet e Biznesit. Te gjitha pretendimet ne lidhje me ryshfetin ose korrupsionin jane hetuar.


Kur Shoqeria zbulon se akuzat per ryshfet ose mashtrim jane ngritur ndaj ndonje pale te trete qe kryen pune per Shell, Shoqeria rishikon marredheniet me ate pale dhe ndermerr veprimet e duhura. Nuk ka ndodhur ndonje ngjarje e tille gjate vitit financiar te mbyllur me 31.12.2020.

SISTEMI I KONTROLLIT TE BRENDSHEM DHE MANAXHIMI I RISKUT NE LIDHJE ME RAPORTIMIN FINANCIAR

Manaxhimi, se bashku me ekipet mbeshtetese te finances, eshte pergjegjes per mirembajtjen e nje sistemi te shendoshe te manaxhimit te riskut dhe kontrollit te brendshem, dhe per rishikimin e rregullt te efektivitetit te tij. Departamentet e financave e ndihmojne ate ne permbushjen e pergjegjesive ne lidhje me kontrollin e brendshem dhe raportimin financiar.

Ekziston nje kornize e vetme e pergjithshme e kontrollit per SUA qe eshte krijuar per te manaxhuar me teper se sa per te eliminuar riskun e deshtimit ne arritjen e objektive te biznesit. Prandaj, ai ofron vetem nje siguri te arsyeshme dhe jo absolute perkundrejt keqdeklarimit ose humbjes materiale.

Diagrama me poshte ilustron komponentet kryesore te Kornizes se Kontrollit te perdorur ne Grupin Shell, qe eshte i zbatueshem edhe per SUA: "Themelet", "Proceset e Manaxhimit" dhe "Strukture". "Themelet" perbehen nga objektivat, parimet dhe rregullat qe mbeshtesin dhe vendosin kufijte per aktivitetet e Shell. "Proceset e Manaxhimit" i referohen proceseve me te rendesishme te menaxhimit, duke perfshire menyren se si strategjia, planifikimi dhe vleresimi perdoren per te permiresuar performancen dhe menyren se si risqet duhet te menaxhohen permes kontrolleve dhe sigurimeve efektive. Komponenti "Strukturor" percakton se si bizneset dhe funksionet lehtesojne arritjen e objektive te pergjithshme te biznesit te Grupit Shell.



SISTEMI I KONTROLLIT TE BRENDSDHEM DHE MANAXHIMI I RISKUT NE LIDHJE ME RAPORTIMIN FINANCIAR (VAZHDIM)

Sistemi i manaxhimit te riskut dhe kontrollit te brendshem mbi raportimin financiar eshte nje pjese integrale e Kornizes se Kontrollit. Rishikime te rregullta jane kryer per te identifikuar risqet e rendesishme per raportimin financiar dhe kontrollet kyçe qe jane krijuar per t'i adresuar ato. Keto kontrolle jane te dokumentuara, pergjegjesia eshte caktuar, dhe ato jane monitoruar per efektivitetin funksionimit. Kontrollet e gjetura si jo efektive jane korrigjuar.

Shell ka nje shumellojshmeri procesesh per te marre siguri mbi pershtatshmerine e manaxhimit te riskut dhe kontrollit te brendshem. Risqet ne zhvillim identifikohen permes (nder te tjera) monitorimit te zhvillimeve te jashtme, treguesve te riskut, mesimeve nga incidentet dhe gjetjeve te sigurise, dhe permes vleresimit te planeve te ardhshme te Shell. Nje sere masash jane perdorur per te menaxhuar risqet e ndryshme te Shell-it. Ekzistojne gjithashtu edhe risqe qe Shell i pranon dhe nuk kerkon qe t'i zbusë plotesisht.

Drejtimi eshte pergjegjes per krijimin dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem te pershtatshem mbi raportimin financiar te SUA dhe pergatitjen e Pasqyrave Financiare. Drejtimi i SUA kreu nje vleresim te efektivitetit te kontrollit te brendshem te Shell mbi raportimin financiar dhe pergatitjen e Pasqyrave Financiare bazuar ne Kontrollin e Brendshem – Kuadrin e Integruar. Vleresimi u krye bazuar ne vete-vleresim dhe ne vleresimet e bera nga departamentet pergjegjese per kontrollet e brendshme perkatese brenda Grupit. Bazuar ne kete vleresim, manaxhimi arriti ne perfundimin se, me 31 dhjetor 2020, Kontrolli i brendshem i shoqerise mbi raportimin financiar dhe pergatitjen e Pasqyrave Financiare ishte efektiv.

PERBERJA DHE FUNKSIONIMI I ORGANEVE EKZEKUTIVE DREJTUESE DHE MBIKEQYRESE DHE TE KOMITETEVE TE TYRE

Anetaret e bordit:

- Tatyana, Stepanova – caktuar me 25 shtator 2018 per nje periudhe te pacaktuar;
- Dorine Terwogt – caktuar me 15 shkurt 2021 per nje periudhe te pacaktuar;
- Robert Deutman – caktuar me 15 shkurt 2021 per nje periudhe te pacaktuar;

Anetaret e bordit jane njelloj pergjegjes per funksionimin ne menyre korrekte dhe efektive te njesise ekonomike. Bazuar ne informacionin e dhene ata analizojne aspekte te ndryshme te njesise ekonomike dhe marrin vendime strategjike.

Ne vitin 2020 nuk eshte mbajtur asnje mbledhje bordi.

Manaxhimi i drejtperdrejte ekzekutiv i Deges kryhet nga Administratori, i cili eshte nje perfaqesues ligjor i zgjedhur nga Bordi. Anthonie Marinus Frens u emerua ne kete rol ne 10 nentor 2020 per nje periudhe te pacaktuar.

**POLITIKA TE NDRYSHME TE ZBATUARA LIDHUR ME ORGANET EKZEKUTIVE
DREJTUESE DHE MBIKEQYRESE**

Per perfshirjen e organeve drejtuese, zbatohen Parimet e Pergjithshme te Biznesit te Shell. Siç pershkruhet ne paragrafin e pare te raportit, ka shume rregullore te brendshme te detajuara te bazuara ne Parimet e Pergjithshme te Biznesit te Shell – sic jane Kodi i Sjelljes, Kodi i Etikes dhe manualet mbi te qenurit ne perputhje me ato rregullore.

10.11.2021


Miratur nga:

Anthonie Marinus Frens, Administrator

Shell Upstream Albania B.V. – Dega ne Shqiperi



RAPORTI I PAGESAVE NDAJ INSTITUCIONEVE SHTETERORE
PER VITIN FINANCIAR TE MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2020



RAPORTI I PAGESAVE NDAJ INSTITUCIONEVE SHTETERORE

Raport i pagesave ndaj institucioneve shteterore eshte pergatitur ne perputhje me nenin 21 te Ligjit nr. 25/2018 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", efektiv qe nga data 1 janar 2019.

Totali i shumes se pagesave te bera nga Shell Upstream Albania B.V. – Dega ne Shqiperi drejt qeverise shqiptare ne vitin 2020 eshte: 405,421,901 leke, e cila konsiston ne pagesa te bera drejt institucioneve te meposhtme:

Emri i institucionit shteteror	Natyra e pageses	Shuma ne leke	Periudha e pageses	Metoda e pageses
DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE	Kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore dhe tatimi mbi te ardhurat personale nga punesimi	346,836,687	Mujore	Transferte bankare
DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE	Tatim ne burim	26,809,214	Mujore	Transferte bankare
AGJENCIA KOMETARE E BURIMEVE NATYRORE	Bonus per Trajnim	31,776,000	Nje here	Transferte bankare
Totali		405,421,901		

Te dhenat e paraqitura ne kete raport jane nxjerre nga sistemi i kontabilitetit dhe ekstrakti bankar i Raiffeisen Bank Sh.a.. Vetem pagesat, te bera si nje pagese e vetme apo si nje seri pagesash te nderlidhura, jane marre ne konsiderate per qellime te ketij raporti me kufi 13.5 milion leke brenda nje periudhe raportuese, sic kerkohet nga neni 21, pika 3 e Ligjit 25/2018 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

10.11.2021

Miraturar nga:

Anthonie Marinus Frens, Administrator

Shell Upstream Albania B.V. – Dega ne Shqiperi



RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarin dhe Drejtimin e Shell Upstream Albania B.V. -Dega në Shqipëri

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare Shell Upstream Albania B.V. -Dega në Shqipëri ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2020, si dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe të ndryshimeve në kapital dhe të flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar Auditimit (SNRF).

Baza për opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të veçanta të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) ("Kodi i BSNEPK") dhe me me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë ("Kodi IEKA"), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 " Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", të ndryshuar, që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK dhe Kodin IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Shell Upstream Albania B.V. -Dega në Shqipëri për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 nuk janë audituar më parë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi dhe personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizem profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencat auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është me i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetedijshme e gjithë informacionit, keq përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- ▶ Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga Drejtimi.
- ▶ Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- ▶ Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Shell Upstream Albania B.V. -Dega në Shqipëri përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Raport për Informacione të Tjera

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin e Drejtimit të Shoqërisë për vitin 2020, përgatitur në përputhje me nenet 17, 18, 19 dhe 21 të Ligjit Nr. 25\2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti i Drejtimit të Shoqërisë për vitin 2020 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me gabime materiale. Nëse bazuar në punën e kryer ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë gabime materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega në Shqipëri

Ernst & Young Certified Auditors
19 Nëntor 2021
Tiranë, Shqipëri



Mario Vangjel
Auditues Ligjor

Mario Vangjel